

PROCESVERBAL
nga seanca e 15 -të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike audio dhe Audiovizuele,
mbajtur më 18.5.2023

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lllazar Trajçev, Zoran Fidanoski .

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishmit nga Shërbimi Profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, Goran Radunoviq, mr. Arben Saiti, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë : /

Z. Petrushevski hapi seancën e 15-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 14:30 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Z. Petrushevski sqaroi se në seancë janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Këshillit, por z. Jançeski ka pasur problem teknik që do ta zgjidhë në vijim. Në lidhje me Rendin e ditës të propozuar, ai shpjegoi se gjatë leximit do të shtojë edhe një pikë të re 5 - Propozim për fillimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR JON-RADIO SHPK Strugë, nr.08-234, datë 30.4.2019, e cila do të shtohet pas pikës 4 për të cilën Këshilli në kohë ka marrë materialin.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, (votimi i z. Janceski ishte me audio link) miratoi ndryshimin si vijon:

RENDI I DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 14-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 5.3.2023.
2. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj TV Iris nga Shtipi për shkelje të nenit 15 paragrafi (1) të Ligjit për media .
3. Propozim për vërejtje publike TV Iris nga Shtipi për shkelje të nenit 15 paragrafi (3) të Ligjit për media .
4. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj TV 21 -M nga Shkupi për shkelje të nenit 15 paragrafi (3) të Ligjit për media .
5. Propozim për inicimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim në radio ndaj SHTR JON-RADIO SHPK Strugë, nr.08-234, datë 30.4.2019 .

6. Propozim për dhënie miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Mirëmbajtja e kompjuterëve dhe pajisjeve të tjera TIK.
7. Propozim për dhënie miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Hulumtim - Analiza e çështjeve gjinore dhe mënyra e paraqitjes dhe përfaqësimit të grave dhe burrave në programet e transmetuesve .
8. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi dhe njëzëri (votimi i z. Janceski ishte me audio link) miratoi procesverbalin e seancës së 14-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 5.3.2023, me tekstin e propozuar.

Pikat 2, 3 dhe 4

Z. Petrushevski sugjeroi që për Pikat 2 dhe 3, meqë bëhet fjalë për media të njëjtë me shkelje të ndryshme të ligjit, të bëhet një hyrje dhe diskutim i përbashkët dhe pastaj të votohet për secilën prej tyre veçmas.

Z. Trajçevski në shpjegimin e hyrjes propozoi të shtohet pika 4 sepse është shkelje nga nen i njëjtë i Ligjit për mediat, edhe pse kemi të bëjmë me transmetues të ndryshëm.

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit mr. Magdalena Davidovska Dovleva, sqaroi Propozimet për shqiptimin e masës vërejtje publike të TV Iris nga Shtipi për shkelje të nenit 15 paragrafi (1) dhe nenit 15 paragrafit (3) të Ligjit për media dhe Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike për TV 21 -M nga Shkupi për shkelje të nenit 15 paragrafi (3) të Ligjit për media. Ajo shpjegoi se sipas nenit 15 të Ligjit për Media, transmetuesit janë të detyruar të sigurojnë transparencë (publicitet) në punën e tyre. Pika 2 i referohet TV IRIS dhe detyrimit për t'i dorëzuar Agjencisë të dhënat për punën e tyre më së voni deri më 31 mars. Ky është i vetmi transmetues që nuk e ka përmbushur këtë detyrim dhe sipas ligjit, propozimi është që t'i shqiptohet masë vërejtje publike dhe t'i jepet afat prej 45 ditësh për ta përmbushur detyrimin. Në lidhje me pikën 3, ajo shpjegoi se është për të njëjtin transmetues, por për një paragraf të ndryshëm nga ky nen, domethënë pjesë të të dhënave që duhet të dorëzojnë në Agjenci duhet të publikohen në programin e tyre dhe (inçizim) regjistrim të shpalljes duhet të dorëzohet në ASHMA. TV Iris nuk e ka përmbushur këtë detyrim dhe po ashtu propozohet masë vërejtje publike dhe t'i jepet afat prej 45 ditësh për të përmbushur detyrimin. Lidhur me pikën 4, ajo sqaroi se TV 21 -M nga Shkupi i ka dorëzuar të dhënat në Agjencion, por nuk e kanë përmbushur detyrimin që ato të dhëna t'i publikojnë në programin e tyre dhe të dorëzojnë regjistrimin e njoftimit në Agjenci, që do të thotë. se kanë përmbushur pjesërisht detyrimin nga ligji. Ajo tha se edhe për këtë transmetues propozimi është masë vërejtje publike dhe t'i jepet afat prej 45 ditësh për të respektuar Ligjin.

Z. Trajçevski në lidhje me Pikën 2 sqaroi se mospërmbushja e detyrimit në afat prej 45 ditësh nga pranimi i Akvendimit për ndërmarrje të masës për vërejtje publike nënkupton edhe heqjen e lejes.

Udhëheqësja mr. Magdalena Davidovska Dovleva, sqaroi se kjo vlen për Pikat 2 dhe 3, që do të thotë se transmetuesit do t'i jepet afat prej 45 ditësh për të përmbushur detyrimet nga paragrafi (1) dhe paragrafi (3) i nenit 15 të Ligjit për media dhe nëse në afatin shtesë nuk

e përmbushin detyrimin “organi rregullator kompetent do t'i heqë lejen për transmetim në televizion dhe radio”.

Z. Petrushevski kërkoi nga shërbimi që t'i telefonojnë personalisht që të dinë se kjo shkelje mund të ketë pasoja të rënda dhe të mos vijnë në situatë që të mbesin pa leje për një gjë të tillë.

Z. Fidanoski tha se dëshiron ta vijojë diskutimin dhe pyeti në rast se pas mbikëqyrjes së kontrollit nëse nuk përmbushet detyrimi, atëherë a hapet procedurë standarde për marrjen e lejes siç është vepruar deri më tani dhe më pas kanë 15 ditë shtesë për të përmbushur detyrimin?

Z. Trajçevski u përgjigj pozitivisht.

Z. Ajdini tha se kishte pyetje në lidhje me Pikën 4 për TV KOMPANI 21 -M. Ai shikoi deklaratat në materialet që ata kishin dhe pyeti nëse transmetuesi ishte kontaktuar ndërkohë?

Udhëheqësja Davidovska Dovleva ka sqaruar se personalisht ka biseduar me përfaqësuesin e televizionit dhe ia ka shpjeguar plotësisht detyrimin nga neni 15 paragrafi (3) i Ligjit për media. Në këtë rast ende përdoret vërejtja publike sepse nuk është bërë brenda afatit ligjor , ndonëse transmetuesi në ndërkohë ka dorëzuar regjistrimin e njoftimit. Tani do të kryhet mbikëqyrje kontrolli dhe do të konstatohet nëse e kanë përmbushur detyrimin. Për sa i përket TV Iris shpjegoi se për të dyja shkeljet u është dërguar njoftim se kanë të drejtë të deklarojnë, njoftimin e kanë pranuar, por nuk kanë paraqitur deklaratë. Ajo tha se nëse Këshilli mendon se është mirë t'i thërrasë me telefon, ata do ta bëjnë këtë dhe do t'u sqarojnë se kanë afat prej 45 ditësh dhe më pas nëse nuk e përmbushin detyrimin do të vijojë procedura për heqjen e lejes.

Z. Petrushevski tha se është më mirë t'i telefononi dhe t'u sqaroni se sa të filloni procedurë për heqjen e lejes.

Z. Ajdini u pajtua me propozimin e z.Petrushevski.

Votimi për pikën 2

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt administrative, nr. 03-1894/1 të datës 2.4.2023 dhe njëzëri (votimi i z. Jançeski ishte me audio link) konkludoi ndaj SHTR televizioni IRIS SHPK Shtip t'i shqipton masë vërejtje publike për shkelje të nenit 15 paragrafi (1) nga Ligji për media, sepse nuk ka dorëzuar në Agjenci të dhëna për strukturën e pronësisë, redaktorin/redaktorët përgjegjës dhe për burimet e financimit në vitin 2022, totalin e të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara nga ofrimi i aktivitetit në vitin 2022 dhe për shikueshmërinë mesatare në vitin 2022.

Në përputhje me Udhëzimin për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës nr. 01-4139/1 datë 7.11.2022, detyrohet që në afat prej 45 ditësh nga data e pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Media .

Sektori për çështje juridike dhe furnizim publik të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Sektori për planifikim strategjik dhe të Drejtën e Autorit pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk veproi).

Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshilli duhet ta publikon aktvendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

Votimi për pikën 3

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e krye të rregullt administrative, nr.03-1892/1 të datës 2.4.2023 dhe njëzëri (votimi i z. Jançski ishte me audio link) konkludoi për Televizionin SHTR IRIS SHPK Shtip, t'i shqipton masë vërejtje publike për shkelje të nenit 15 paragrafin (3) të Ligjit për Media, sepse në afatin e parë nuk ka publikuar në programin e tij të dhënat për strukturën e pronësisë, redaktorin/redaktorët përgjegjës dhe burimet e financimit në vitin paraprak (reklama, sponsorizim, shitjen e përmbajtjeve, shërbimet e ofruara palëve të treta, etj.) dhe nuk ka dorëzuar regjistrimin e njoftimit në Agjenci brenda 15 ditëve nga dita e publikimit.

Në përputhje me Udhëzimin për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës nr. 01-4139/1 datë 7.11.2022, detyrohet që në afat prej 45 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Media .

Sektori për çështje juridike dhe furnizim publik të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtën e autorit pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryern mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk veproi).

Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshilli duhet ta publikon aktvendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

Votimi për pikën 4

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt administrative , nr.03-1891/1 të datës 24.4.2023 dhe njëzëri (votimi i z.Jançevski ishte nëpërmjet lidhjes audio) konkludoi ndaj SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup t'i shqipton masë vërejtje publike për shkelje të nenit 15 paragrafi (3) të Ligjit për Media, sepse në afatn e parë nuk ka publikuar në programin e tij të dhënat për strukturën e pronësisë, redaktorin/redaktorët përgjegjës dhe burimet e financimit në vitin paraprak (reklama, sponsorizimi, shitja e përmbajtjeve, shërbimet e ofruara palëve të treta, etj.) dhe nuk ka dorëzuar regjistrimin e njoftimit në Agjenci brenda 15 ditëve nga dita e publikimit.

Në përputhje me Udhëzimin për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës nr. 01-4139/1 datë 7.11.2022, detyrohet që në afat prej 45 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizoj punën e tij me dispozitat e Ligjit për Media.

Sektori për çështje juridike dhe furnizim publik të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtën e autorit pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryern mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk veproi).

Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshilli duhet ta publikon aktvendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 5

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR JON-RADIO SHPK Strugë, nr.08-234, datë 30.4.2019. Ai ka shpjeguar se ky transmetues nuk ka paguar tarifën për lejen e transmetimit në radio në afatin e paraparë ligjor prej 30 ditësh. Ai bën të ditur se para disa ditësh ka kontaktuar me njërin nga pronarët dhe e kanë siguruar se pagesa do të bëhet gjatë javës së ardhshme dhe shpreson që në seancës e datës 29 maj të ketë propozim për ndërprerjen e kësaj procedure.

Z. Petrushevski tha se është mirë që të informohen për afatin e fundit të pagesës, përkatësisht ai afat fillon nga dita e vërtetimit të propozimit për fillimin e procedurës në arkivin e Agjencisë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri (votimi i z. Jançeski ishte nëpërmjet lidhjes audio) inicioi procedurë për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive JON-RADIO SHPK Strugë, nr.08-234, datë 30.4.2019, për shkak të shkeljes së nenit 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 184/13, 13/14 , 44/14, 101/14 , 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19) dhe (Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 42/20 dhe 77/21) .

Sipas Raportit me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt administrative me nr.05-2107/1 datë 16.5.2023, transmetuesi nuk ka plotësuar detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, gjegjësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio ndaj Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk e paguan kompensimin (tarifën) vjetore të lejes në përputhje me faturën e dhënë (lëshuar) nga Agjencia, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për fillimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive JON-RADIO SHPK Strugë nr.08-234 datë 30.4.2019.

Pika 6

Udhëheqësja e sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska ka shpjeguar Propozimin për dhënie miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Mirëmbajtja e kompjuterëve dhe pajisjeve tjera TIK. Ajo shpjegoi se është furnizim i rregullt publik që kryhet çdo dy vjet. Prokurimi është paraparë në Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2023 dhe mjetet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023, përkatësisht do të sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për vitin 2024. Kjo do të thotë se kontrata që rezulton do të lidhet për periudhë kohore prej 2 vjetësh dhe do të zbatohet si procedurë e hapur e thjeshtuar. Të gjitha informacionet e tjera të nevojshme gjenden në materialet pas pikës.

Z. Petrushevski pyeti nëse pagesa do të bëhet vetëm për punët që do të kryhen, gjegjësisht nuk duhet të shpenzohen të gjitha mjetet?

Udhëheqësja Mitrevska sqaroi se kështu është, pagesa do të jetë sukcesive (e njëpasnjëshme) dhe do të paguhet pas kryerjes së shërbimit, natyrisht nëse ka nevojë për një shërbim të caktuar, Agjencia nuk është e obliguar t'i shpenzojë të gjitha mjetet.

Këshilli i Agjencisë njëzëri (votimi i z. Jançeski u bë me audio link) miratoi zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Mirëmbajtja e kompjuterëve dhe pajisjeve tjera TIK.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën-shërbim: Mirëmbajtja e kompjuterëve dhe pajisjeve të tjera TIK është parashikuar dhe është në përputhje me Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2023 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-4766/ 1 datë 23.12.2022, dhe mjetet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023, përkatësisht do të sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për vitin 2024.

Pika 7

Udhëheqësja e sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik Cvetanka Mitrevska, sqaroi Propozimin për dhënie miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Hulumtim - Analiza e çështjeve gjinore dhe mënyra e paraqitjes dhe përfaqësimit të grave dhe burrave në programet e transmetuesve. Ajo ka sqaruar se Agjencia këtë prokurim e kryen çdo vit dhe kjo nevojë është paraparë në Programin e Punës së Agjencisë për vitin 2023. Prokurimi është paraparë në Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2023 dhe mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023. Do të realizohet si prokurim me vlerë të ulët dhe të gjitha të dhënat e tjera gjenden në materialet që dorëzohen pas pikës.

Z. Petrushevski kujtoi se Kuvendi çdo vit ka një pikë të tillë në një nga komisionet dhe se këto rezultate shfrytëzohen.

Z. Trajçevski sqaroi se ky detyrim buron nga një ligj tjetër, nga Ligji për mundësi të barabarta të grave dhe burrave, ku Agjencia është e obliguar ta bëjë këtë hulumtim dhe rezultatet e hulumtimit duhet t'i dorëzohen Kuvendit të RMV-së.

Z. Petrushevski tha se të dhënat që do të dalin nga ky hulumtim nuk i shfrytëzon vetëm Agjencia, por edhe Kuvendi, e me këtë edhe publiku.

Z. Trajçev tha se Këshilli po voton vetëm për dhënien e miratimit për nevojën e prokurimit dhe deklaroi se do të japë miratim. Mirëpo, duke qenë se në materialet e inspektimit është dorëzuar edhe specifikimi teknik, në të cilin shihet se 40% është çmimi si kriter për vlerësimin e ofertës më të favorshme, në parim qëndrimi i tij është se edhe pse Këshilli nuk është kompetent, mund të tregon se nuk pajtohet me këtë.

Z. Fidanoski tha se do ta vazhdojë diskutimin e z. Trajçev. Ai shpjegoi se për hulumtime të tilla të ndjeshme apo pika ku cilësia duhet të dalë në sipërfaqe, sepse përfitues të këtij hulumtimi do të jenë dhe institucione të tjera, jo vetëm Agjencia, për këtë duhet vlerësuar cilësia e punës. Për këto arsye, ai konsideron se raporti 40-60 është adekuat dhe do të ofrojë mbështetje për prokurimin publik.

Këshilli i Agjencisë njëzëri (votimi i z. Jançeski ishte nëpërmjet lidhjes audio) miratoi zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Hulumtim - Analiza e çështjeve gjinore dhe mënyra se si paraqiten dhe përfaqësohen gratë dhe burrat në programet e transmetuesve.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën-shërbim: Hulumtim - Analiza e çështjeve gjinore dhe mënyra e paraqitjes dhe përfaqësimit të grave dhe burrave në programet e transmetuesve është paraparë dhe është në përputhje me Planin Vjetor të Prokurimit Publik për vitin 2023 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-4766/1 datë

23.12.2022, dhe mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023.

Pika 8

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

Nr. 02-2016/8

30.05.2023

Shkup

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**